



## P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **04.03.2020** me fillim në ora **10.15**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Bajram Morina.  
**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete, z. Lendrit Qelin, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të UNMIK-ut, të KFOR-it të LMT-së. Ky është takimi i parë për vitin 2020, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

### R E N D I T E

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – Pasi që është takimi i parë për vitin 2020, ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe sa më shumë suksese. E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

#### 1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit, E qes në votim pikën e parë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### 2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2019.

**Kryesuesi** – Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të takimeve të Komitetit për Komunitete, ku janë mbajtur 6 takime të rregullta dhe 1 takim i jashtëzakonshëm në vitin 2019. Në këto takime janë shqyrtuar qeshjet e ndryshme që kanë pasur të bëjnë pozitën dhe gjendjen e komuniteteve jo shumicë në komunën tonë. Probleme që janë shqyrtuar në këto mbledhje janë: Problemet dhe disa kërkesa që duhet përmirësuar në segmentin e infrastrukturës si kanalizimi, kubëzimi, asfaltimi, ndriçimi dhe vendosja e kontejnerëve të vendbanimit ku jeton komuniteti jo shumicë. Pastaj gjendja e përmirësimit në fushën e arsimit në komunitetin jo shumicë, si vizita në shkollë. shqyrtimi i Planit të veprimit për Komunitetet Romë, ashkali dhe egjiptian për vitin 2019 – 2021. Gjendja e sigurisë së komunitetit jo shumicë, participimi dhe pjesëmarrja në këshillin për siguri në bashkësi, vizita në stacionin e policisë në Rahovec, pjesëmarrja në sesione punuese në nivel lokal dhe qendror rreth sigurisë së komuniteteve etj. këto pa ishin disa nga pikat më kryesore që janë shqyrtuar në vitin 2019, janë edhe disa pika tjera të cilët keni mundësi të i gjeni në raportin që e keni të gjithë para vete.

**Mirjeta Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, gjatë vitit që lamë pas ne u munduam që të shfaqim të gjitha problemet të cilat i kanë pjesëtarët e komunitetit pakicë, ku në bashkëpunim me komunën dhe zyrën për kthim dhe komunitete sadopak të i lehtësojmë problemet e tyre. Ne gjatë këtij viti kemi parë se si problem kryesor i komuniteteve pakicë është infrastruktura dhe si sfidë është edukimi, prandaj kërkoj më shumë angazhim në vitin 2020 rreth edukimit të moshës së hershme, ku

kishte me qenë mirë që në bashkëpunim me ndonjë shoqatë ti etiketojmë personat e duhur dhe të dërgohen në shkollat profesionale dhe jo të lihen në rrugë.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit e nderuar, nëse nuk ka askush të shtoj diçka rreth pikës së dytë, kalojmë në pikën e radhës:

### 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.

Të nderuar anëtar të Komitetit për Komunitete planin e punës besoj se të gjithë e keni para vete, nëse ka dikush të shtoj diçka rreth këtij plani fjala është e juaja. Atëherë pasi nuk ka askush të shtoj diçka rreth Planit të punës për vitin 2020, e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020. Kalojmë në pikën e radhës:

### 4. Të ndryshme.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, besoj se viti 2019 ka qenë një vite i mirë për komunitetin jo shumicë, shumica e shqetësimeve të dala nga ky komitet, ekzekutivi komunal ju është përgjigjur pozitivisht dhe për këtë i falënderojmë. Shpresojmë se ky bashkëpunim me komunën do të vazhdojë edhe në vitet në vijim, po ashtu shpresojmë se komuniteti jo shumicë në komunën tonë të ketë sa më pak probleme në vitet në vijim, si në infrastrukturë ashtu edhe problemet e tjera.

**Darko Antiq** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua të cekim edhe një herë shqetësimin të cilin e kam cekur në mbledhjet e kaluara, problemi është lidhur me kontejnerët për mbeturina në lagjen e epërme. Ne si lagje kemi probleme serioze sa i përket mbeturinave, ne kemi pritur se këtë vite do të bëhet nderimi i kontejnerëve të vjetër me kontejner të rinj të plastikës, ashtu na është premtuar nga drejtori i shërbimeve publike. Jemi duke parë se në qytet janë bërë nderimet e kontejnerëve kurse në lagjen tonë ende asgjë nuk është bërë, pres ndonjë përgjigje rreth kësaj pyetje.

**Lendrit Qeli** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, I nderuar sa i përket kontejnerëve ato do të zëvendësohen shumë shpejtë, ne kemi vendosur në tenderim një projekt që kushton rreth 45,000.00 €, në këtë projekt përfshihet, sanimi dhe rregullimi i 5 rrugicave ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, ku 2 nga këto rrugë është rregulluar, njëra në fshatin Xërxë dhe tjetra në Çifllak. Presim që punimet të përfundojnë në fshatin Hoçë e Madhe, pastaj sanimi i disa rrugicave në lagjen e epërme të Rahovecit dhe rregullimi i një rruge të re sa i përket komunitetit serb. Por mos të harrojmë që në brendësi të këtij projekti është edhe vendosja e kontejnerëve të rinj në lagjen e epërme. Kisha kërkuar mbështetje nga ana juaj, dje kam pasur një takim me majorin e FSK-së pra i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me komunitetin jo shumicë, ku ka kërkuar nga ne që në të ardhmen të kemi bashkëpunime kryesisht në projekte që kanë të bëjnë me sensibilizimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve të komunitetit jo shumicë. Kishte me qenë mirë që të ndërhyrë në fshatin Hoçë e Madhe me realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve piroteknike, pse jo edhe në aktivitetet tjera të cilat ndihmojnë në sensibilizimin e komunitetit. Banorët e këtij fshati deri më tani nuk kanë treguar gatishmëri për bashkëpunim, prandaj kisha kërkuar nga kolegët të cilët jetojnë në fshatin Hoçë e Madhe që ta kemi një bashkëpunim ma konstruktiv në këtë drejtim. Kurse sa i përket punës së zyrës për kthim dhe komunitete për vitin 2019, raportin e keni të publikuar në web faqe të komunës, ku mund të hynë të lexoni, ne po ashtu i përditësojmë raportet periodike për çdo tre muaj, për çdo gjë ne jemi këtu për të bashkëpunuar me ju.

**Mirjeta Krasniqi** – Falënderoj z. Lendrit Qelin për informatat që na i dha, po ashtu e falënderoj për angazhimin e madhe që e bënë në bashkëpunimin me komunitetet jo shumicë që jetojnë në komunën tonë. Ajo që desha unë të them është se është mirë që ti qëndrojmë në përpikëri këtij plani, po ashtu të mbahen mbledhjet vazhdimisht në mënyrë të rregullt, po ashtu anëtarët e këtij komiteti të njoftohen përveç emailave edhe me telefon, në mënyrë që të mos mungojmë askush në takimet e këtij komiteti.

**Kryesuesi** – Nëse nuk ka askush të shtoj diçka, ju faleminderit për pjesëmarrje të gjithëve shihemi në takimet e radhës!

**Mbledhja përfundoi në orën: 10:45**

Procesmbajtësi

Agim Hoti

